



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura e VI
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 01/17
Prishtinë, më 10.10.2017, ora 12:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje e Komisionit morën pjesë: Lumir Abdixhiku, Dardan Molliqaj, Ali Lajqi, Mytaher Haskuka, Naser Osmani, Mërgim Lushtaku, Blerim Kuçi, Enver Hoti dhe Myfera-Serbica-Sinik.

Munguan: Safete Hadërgjonaj dhe Jelena Bontiq.

Pjesëmarrës të tjerë: Rejhane Zylfaj, Mentor Hyseni – GIZ, Semra Çitaku – Ambasada Britanike.

Nga stafi mbështetës i Komisionit: Sabrije Iseini, Luljetë Krasniqi dhe Dashurije Canolli.

Mbledhjen e kryesoi: Kryetar i Komisionit – Lumir Abdixhiku

Rendi i ditës

1. Konstituimi i Komisionit.

Kryetari – siç jemi të njoftuar, Kuvendi ka bërë themelimin e komisioneve parlamentare. Komisioni për Buxhet dhe Financa, përbëhet prej 11 anëtarësh. Më pas kryetar, në bazë të Vendimit të Kuvendit, lexoi emrat e anëtarëve dhe pozitat e tyre në komision. Po ashtu prezantoi edhe stafin e njësisë mbështetëse të komisionit. Ju e keni marrë rendin e ditës, a ka kundërshti nëse jo a aprovojmë rendin e ditës.

Rreth fushëveprimt të punës së Komisionit, në bazë të Rregullores së Kuvendit, Komisioni për Buxhet dhe Financa, ushtron dy funksione: është komision funksional, sikurse të gjitha komisionet tjera që mbulojnë një fushë të caktuar të trajtimit dhe mbikëqyrjes së çështjeve në lëmin e buxhetit dhe financave, por është edhe komision i përhershëm.

Në cilësinë e komisionit funksional – shqyrton çështjet që kanë të bëjnë me buxhetin dhe financat në Kosovë. Në këtë kontekst, Komisioni shqyrton Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve, Projektbuxhetin vjetor të Republikës së Kosovës dhe rishikimin e tij, Raportet financiare të Buxhetit, të përgatitura nga Qeveria, raportet vjetore të institucioneve të pavarura që dërgohen në Kuvend, të cilat i raportojnë Kuvendit. Komisioni shqyrton projektligjet që hartohen nga ministria e resorit përkatës (Ministria e Financave) dhe dërgohen për miratim në Kuvend. Si dhe bënë mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve në fushën e vetë, monitorimin e realizimit të të hyrave buxhetore (zbatimin e buxhetit), monitorimin e zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (pjesa që ka të bëjë me financat publike dhe sistemin

financiar), si dhe çështjet tjera në pajtim me fushëveprimin dhe përgjegjësitë e komisionit të përcaktuar me Rregulloren e Kuvendit dhe Planin dhe Programin vjetor të komisionit. Në cilësinë e komisionit të përhershëm – shqyrton të gjitha projektligjet e propozuara në Kuvend, dhe amendamentet e propozuara nga Komisionet funksionale dhe subjektet tjera që ka të drejtë të propozojnë amendamente për projektligje, në aspektin e ndikimit buxhetor dhe financiar.

Komisioni do të bashkëpunojë me ministrinë e resorit përkatës që është Ministria e Financave, dhe me të gjitha ministritë e tjera dhe institucionet tjera lokale dhe qendrore. Po ashtu do të bashkëpunojmë me organizatat e shoqërisë civile vendore dhe organizatat apo institucionet ndërkombëtare me seli në Kosovë që ofrojnë gatishmëri për bashkëpunim.

Komisioni ka mbështetje nga Projekti i GIZ-së, që është një projekt afatgjatë, që ka filluar në vitin 2009 dhe do të vazhdojë deri qershor të vitit 2018. Është një projekt i gjerë, i fokusuar në financat publike, qëllimi kryesorë i projektit është mbështetja dhe fuqizimi i Komisionit dhe stafit, përmes ofrimit të ekspertizave, këshillave, trajnimeve, në procesin e shqyrtimit të projektbuxhetit dhe mbikëqyrjes buxhetore, dhe aktiviteteve tjera të komisionit. Unë kam pas pasur një takim me Rejhane Zylfijaj, eksperte e financave publike në GIZ, kur ndër të tjera kemi diskutuar për mundësinë e organizimit të një punëtorie një ditore dhe ku do të kemi rastin të njoftohem më për se afërmi me mbështetjen që do të ofrojë GIZ, për komisionin.

Janë edhe dy çështje tjera që dëshiroj ti diskutojë. E para ka të bëjë me caktimin e një dite për mbajtjen e mbledhjeve të rregullta të komisionit. Nëse nuk gabojë, mandatin e kaluar kanë qenë të mërkurave prej orës 11:00. Çështja e dytë ka të bëjë me caktimin e datës së ardhshme për shqyrtimin në parim të Projektligjit për Rishikimin e Buxhetit 2017. Ministri i Financave është jashtë vendit dhe mendojë që është mirë me prituri ministrin dhe javën tjetër të shqyrtojmë bashkërisht projektligjin.

Naser Osmani - urojë punë të mbarë dhe shpresojë se do të kemi mundësi të mira bashkëpunimi me të gjithë deputetët. Të kam thënë dhe tani po e përsërisë publikisht se ke fatin si kryetar që e ke këtë staf. Ajo çka konsideroj është e mirë me fillue menjëherë me bë plane, me i aktivizue grupet punuese me mbështetjen edhe të GIZ-it. Sa i përket rishikimit të buxhetit më duket se të premtën bëhen dhjetë ditë. Propozoj që të martën të kemi një mbledhje për shqyrtimin në parim të rishikimit të buxhetit.

Dardan Molliqaj – nuk e di sa prej nesh jemi në dy komisione, por unë jam edhe anëtar i Komisionit për zhvillim ekonomik, dhe në atë komision me kërkesën time është vendosur që mbledhjet e rregullta të mbahen të martave prej orës 11:00, pasi që se prej stafi u informova që Komisioni për Buxhet dhe Financa, i mban mbledhjet të mërkurave. Për javën e ardhshme ndoshta mos me pas mbledhje fare, pasi që Kuvendi ende nuk ka filluar punën. Ndoshta mundemi me i caktua mbledhjet në atë komision në orën 10:00 e këtu me i lënë në orën 13:00, që mos kemi ndeshje të kohës.

Kryetari – propozoj që mbledhjet e rregullta të komisionit të jenë të mërkurave në orën 11:00. Ndërsa me qenë se e kemi çështjen e rishikimit me buxhetit me urgjencë, mendojë që mund të pajtohemi që javën e ardhshme të mbajmë mbledhjet të martën në orën 13:00.

Enver Hoti - mendoj që është mirë me trajtue në nivel të komisionit harmonizimin e agjendave me komisione tjera sepse ne jemi të shpërndarë siç tha kolegu nëpër disa komisione në mënyrë që të koordinojmë kohën dhe mundësin e pjesëmarrjes në mbledhjet e komisioneve.

Kryetari – me qenë se komisioni ynë është ndër komisionit më të rëndësishme dhe prioritetet do ti japim këtij komisioni me shpresë që kryetarët e komisioneve tjera do ti përshtatin agjendat me komisionin tonë. Një çështjet të fundit që desha të ngris, jam informuar se komisioni se në komisioni në të kaluarën ka pasur një rregullore të brendshme të punës, dhe besojë se është në interes që të kemi edhe tani një rregullore të tillë. Në qoftë se edhe GIZ na mbështet ne e kishim nis punën në hartimin e draft rregullores së brendshme të punës së komisionit.

Mërgim Lushtaku – sa i përket rregullores së brendshme të komisionit, mendojë që është mirë me shikue rregulloren e kaluar dhe të analizojmë se çfarë ka nevojë për ndonjë ndryshim apo plotësim që të përshtatim punën sonë dhe për këtë qëllim mund ta bëjmë një takim të veçantë.

Kryetari – nuk e di gjendjen e rregullores së kaluar, por unë mendojë që ne mund ta marrim nismën për miratimin e rregullores së re, dhe në këtë drejtim do të na ndihmojë përvoja e gjatë e anëtarëve të komisionit, e Naserit dhe Safetës, dhe mbështetja e GIZ-së. Ne do ta analizojmë rregulloren e kaluar dhe të shohim aspektet e plotësimit dhe ndryshimit të saj në përputhjet me nevojat dhe kërkesat tona dhe në harmoni me Rregulloren e Kuvendit.

Blerim Kuqi – pyeti a ekziston apo jo një rregullore e brendshme e komisionit? Nëse ekziston duhet me analizua dhe me pa se çfarë mund të ndryshohet dhe plotësohet nga jo rregullore. Por obligative është Rregulloja e Kuvendit dhe rregullorja e brendshme duhet të jetë në harmoni me këtë rregullore.

Kryetari – ekziston rregullorja e brendshme, por ne duhet ta rikthejmë në komision sepse ka kaluar një kohë e gjatë dhe të shohim pikat e dobëtat dhe ta përshtatim për nevojat e komisionit. Nëse pajtohem kishim filluar punën në hartimin e kësaj rregullore. Nëse nuk keni çështje tjera me diskutue, e kishim mbyllur për sot mbledhjen.

Kryetari konstatoi përfundimin e mbledhjes së komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30

Përgatitur nga Njësia Mbështetëse e Komisionit